



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

Standardet e BE për Bujqësinë Organike

Endrit Kullaj

PROJEKTI

“Përmirësimi i njohurive të fermerëve të bujqësisë organike në lidhje me procesin e Integrimit Evropian”

IPA II European Union Integration Facility 2014 SUPPORT TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS FOR THE IMPLEMENTATION OF CAPACITY BUILDING ACTIONS TO INCREASE POLICY DIALOGUE AND AWARENESS ON EUROPEAN INTEGRATION PROCESS

Struktura e prezantimit



[Origjina e Bujqësisë Organike](#)



[Struktura e Legjislacionit Organik](#)



[Përmbajtja e Përgjithshme](#)



Pionerët e organikës



- ❖ **Albert Howard, Britani e Madhe, 1940**
- ❖ **Eve Balfour, Britani e Madhe, Soil Association, 1946**
- ❖ **Rudolf Steiner, Gjermani, Bujqësi biodinamike, 1924**
- ❖ **Jerome Rodale, SHBA, Bujqësi organike, 1940**
- ❖ **Andre Voisin, France, Bar për gjedhin, 1950's**
- ❖ **Fukuoka, Japan, Bujqësi natyrale, 1970's**

Ndryshimet në bujqësi



- ❖ **Nga 1940 ka patur një rritje në prodhimin bujqësor si rezultat i:**
 - **Plehërave azotike**
 - **Farave hibride**
 - **Mekanizimit**
 - **Pesticideve**
 - **Gjatë viteve 1940, 50, 60 metodat organike nuk ishin të përhapura gjerësisht**

Standarde organike të hershme



- ❖ **Standardi i Soil Association 1967**
- ❖ **Certifikimi privat nisi më 1973**
- ❖ **Rregullorja e parë e BE 2092/91 vetëm për bimët**
- ❖ **Rregullat e para të BE për blegtorinë 1999**
- ❖ **Rregullorja e rishikuar 834/2007**
- ❖ **Në fuqi nga 1 Janari 2009**

Struktura e ligjit që prej vitit 2009



❖ 1 Rregullorja e Këshillit EC 834/2007

- 40 recitals
- 42 nene
- 1 aneks

Këshilli

Komisioni

❖ 2 Rregullore e Komisioneve

- EC 889/2008 Rregullore – prodhimi organik, etiketimi dhe kontrolli
- EC 1235/2008 Rregullore – importi

Nivele të ndryshme



834/2007	889/2008	Ligji kombetar
Rregullat e përgjithshme, objektivat parësorë	Rregulloret, kërkesa të hollësishme, etj.	Autoritetet kompetente, rregulla për derogimin, menaxhimi i databazës së farës, shtame me rritje të ngadaltë, etj



Dispozita të legjislacionit të BE ose kombëtar që rregullojnë prodhimin, përgatitjen, marketingun, etiketimin dhe kontrollin, përfshi legjislacionin për produkte ushqimore për njerëzit dhe blegtorinë.

Objekti: PRODUKTET BUJQËSORE

Rreg. 834/2007 dhe 889/2008



❖ Zbatohet tek produktet bujqësore si vijon:

- Produkte bujqësore* dhe të papërpunuara**
 - ✓ Produkte bimore (përfshi kërpudhat dhe leshterikun e detit) + vjelje spontante
 - ✓ Produkte shtazore: gjedhi, të imëtat, derri, shpendët, bletët, akuakultura (peshqit dhe karkalecat sipas Rreg. 889/08, molusqet, ekinodermet)

* « produkt bujqësor »: Lists në Aneksin I të Traktatit të BE

** « papërpunuar» (Neni 2n Rreg. 852/04): nënkupton produkt ushqimor që nuk i është nënshtruar përpunimit dhe përfshin produkte që janë ndarë, copëtuar, prerë në feta, hequr kockat, grirë, hequr lëkura, prerë, pastruar, bluar, ftohur, ngrirë, e ngrirë thellë ose shkrirë.

Objekti: PRODUKTET BUJQËSORE

Rreg. 834/2007 dhe 889/2008



❖ Zbatohet për produktet bujqësore të mëposhtme:

- Produkte bujqësore të përpunuara* të përdorura si ushqim
- «përpunim» (Neni 2m Rreg. 852/04) nënkupton çdo veprim që ndryshon thelbësisht produktin fillestar, përfshi nxehjen, tymosjen, kurimin, maturimin, tharjen, marinimin, ekstraktimin, shtrydhjen ose një kombinim të këtyre proceseve.
 - Ushqim për kafshët (produkte bujqësore të përpunuara ose jo dhe suplementet ushqyese për blegtorinë dhe akuakulturën)
 - Material vegjetativ për shtim dhe fara për kultivim
 - Majatë e përdorura si ushqim për njerëzit ose kafshët

Objekti: PRODUKTET BUJQËSORE

Rreg. 834/2007 dhe 889/2008



❖ Nuk zbatohet për:

- ✓ Produkte bujqësore të përpunuara që nuk përdoren si ushqim (p.sh: kërpi si material ndërtimi, tekstili, kozmetika, pluhurat larës, cigarette, vajrat joushqimorë ose vajrat esencialë...)
- ✓ Produkte të gjuetisë dhe peshktimit të kafshëve të egra
- ✓ Prodhimi i *Foie gras* (ndalohet ushqimi me racione), rritja e demave (mbajtje në rrethim, blerje e gjedhit jo-organik në moshë të re, majmëria dhe rishitja)
- ✓ Ushqim për kafshët shtëpiake ose kafshët për gëzof
- ✓ Rritja e llojeve që nuk janë listuar: pëllumbi, dreri, ..

kjo listë nuk është shterruese

Objekti: OPERATORËT

Rreg. 834/2007 dhe 889/2008



❖ Zbatohet për:

- **Prodhuesit, Shpërndarësit dhe tregtarët**: çdo operator që ka një aktivitet në stadin e prodhimit, përgatitjes (përpunim, paketim, etiketim), ruajtjes ose shpërndarjes së produkteve organike.
- **Importuesit**: operatorët që importojnë produkte organike nga vende të treta në BE që i nënshtrohet kontrollit (rregullat e importit në BE janë të detajuara në Rreg. 1235/2008).
- **Nënkontraktimi**: aktivitete të kontraktuara nga një operator i nënshtrohen gjithashtu sistemit të kontrollit.

❖ Operatorët e përjashtuar nga kontrolli i detyrueshëm:

- ✓ **Shitësit me pakicë të produkteve të para-paketuara nëse ruhen në pikën e shitjes**

Objekt i (fusha e veprimit) 834/2007

Jashtë objektit të
834/2007

Objekt i 889/2008

Jashtë objektit të
889/2008



Pa logon
e BE

RREGULLAT E PRODHIMIT ORGANIK

Rregullat e konvertimit organik




- Që bimët dhe produktet bimore të konsiderohen organike, në parcela duhet të jenë zbatuar rregullat e prodhimit organik të BE gjatë **një periudhe kalimi (konvertimi)**:

Tipi i kulturës	Periudha e kalimit	Produktet mund të shiten 'në kalim'	Produkti mund të shitet si 'organik'
Njëvjeçare dhe disavjeçare	24 muaj	Nëse vjelja kryhet 12 muaj pas datës së kalimit	Nëse mbjellja ndodh 24 muaj pas datës së kalimit
Shumëvjeçare	36 muaj	Nëse vjelja kryhet 12 muaj pas datës së kalimit	Nëse vjelja ndodh 36 muaj pas datës së kalimit

- Rekomandimi për kulturat shumëvjeçare: **fillimi konvertimit para vjeljes**

Shembull: kalimi për kulturat shumëvjeçare



Rregullat e konvertimit organik

2 raste të kalimit në organik



- Nëse nuk e keni nisur ende procesin e kalimit në sistemin organik:
 - Data e fillimit të kalimit (konvertimit) të parcelave është **data më e hershme e angazhimit** (firmosja e kontratës) të prodhuesit dhe njoftimit të tij për aktivitetin organik tek autoriteti kompetent

- **Nëse e keni nisur procesin e kalimit** (p.sh. blerja ose marrja me qira e një ngastre toke të re):
 - **Data më e hershme e deklarimit** nga operatori për t'u konsiderohen në periudhë kalimi nga autoriteti kontrollues

Koha e operimit përpara kalimit



Zona natyrore ose bujqësore të
patrajtuara me produkte të
paautorizuara për prodhim organik të
paktën për 3 vjet

Periudha e kalimit është e
mundur të zvogëlohet

Livadhe natyrore
Ugare teknike
Tokë e pakultivuar, ugar,
Pyllnajë dhe kënetë



Zona natyrore ose bujqësore të
patrajtuara me produkte të paautorizu-
ara për prodhim organik të paktën për
3 vjet

Farat dhe fidanët



- Duhet të përdoren **vetëm fara dhe material mbjellës i prodhuar sipas sistemit organik.**
- Në rastet kur **nuk gjendet në treg** në formë organike, mund të zëvendësohen me fara ose **material i shtuar në rrugë vegjetative i prodhuar nëpërmjet bujqësisë konvencionale** me kusht që të plotësohen **kërkesat** specifike dhe me **autorizimin paraprak** të dhënë nga Autoriteti Kompetent në vend:
 - ✓ Material Mbjellës Vegjetativ Joorganik: të faktohet që nuk gjendet material organik në treg
 - ✓ Për farat (e njëvjecareve dhe shumëvjecareve) dhe farat e patates: mundësia për të përdorur fara jo-organike dhe fara patatesh me kusht që ato të mos trajtohen me produkte të mbrojtjes së bimëve të ndryshme nga ato të listuara në Aneksin II përveç rasteve kur trajtimi kimik është i parashikuar për qëllime fitosanitare nga Autoriteti Kompetent në vend.
 - ✓ Fidanët njëvjecarë (p.sh.: fidanë perimesh) duhet të jenë medoemos organik, nuk ka përjashtime.

Pjelloria e tokës



- Prodhimi organik i bimëve **përdor punime toke dhe praktika kultivimi** që:
 - Mirëmban ose rrit lëndën organike në tokë
 - Përmirësojë stabilitetin e tokës dhe biodiversitetin e tokës
 - Parandalon ngjeshjen dhe erozionin e tokës
- **Hidroponia është e ndaluar.**
- Bimët që **kultivohen në vazo** gjatë tërë jetës së tyre (bimë të rritura për t'u konsumuar drejtpërdrejt) **nuk mund të certifikohen – Me përjashtim të bimëve aromatike.**
- **Fidanët ne vazo për kultivim mund të certifikohen.**



Pjelloria e tokës



- Pjelloria e tokës duhet ruajtur sipas kërkesave të BE:

Qarkullim
shumevjecar



Bimet
bishtajore dhe
per pleherim
te gjelber



Pleh bagetie ose
materiale
organike



- Nëse kërkesat ushqimore të bimëve nuk mund të plotësohen nga këto masa, mund të përdoren vetëm plehërat dhe përmirësuesit e tokës që referohet në **Aneksin I të Rregullores së BE**

Mbrojtja e bimëve



- Parandalimi i dëmeve të shkaktuara nga sëmundjet, dëmtuesit dhe barërat e këqija:
 - Mbrojtja nëpërmjet armiqve natyrorë (brezat me bimësi që tërheq armiq natyrorë, buburrecët, ...)
 - Zgjedhja e llojeve dhe varieteteve (rezistues ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve)
 - Qarkullimi bimor
 - Agroteknika
 - Procese mekanike dhe termike
- Kur bimët nuk mund të mbrohen nga sëmundjet dhe dëmtuesit nëpërmjet këtyre masave, **mund të përdoren vetëm produkte për mbrojtjen e bimëve që janë referuar në Aneksin II të Rregullores së BE**

Bujqësi organike – konvencionale e përzier



- E gjithë sipërmarrja bujqësore duhet të menaxhohet në përputhje me kërkesat e standardit organik.
- Sidoqoftë, një sipërmarrje mund të ndahet në njësi të veçuara mirë që nuk janë të gjitha të menaxhuara sipas standardeve të prodhimit organik, me kusht që:
 - Për bimët njëvjeçare, të gjithë varietetet do të jenë të ndryshme dhe lehtësisht të dallueshme
 - Duhet të realizohet dhe provohet një ndarje e qartë (toka, produktet e përdorura dhe prodhuara)
- P.sh.: lejohet mbarështim blegtoral jo-organik dhe kopshtari organike
lejohet kultivim drithërash jo-organik dhe pemëtari organike

Bujqësi organike – konvencionale e përzier



- Rregulla prodhimi përjashtimore: **Prodhimi paralel**

Një prodhues mund të kultivojë parcela organike (ose në kalim) dhe jo-organike me varietete të ndryshme por që nuk veçohen lehtë, në rastet e mëposhtme:

Kultura shumëvjeçare

Plani i kalimit brenda **5** vjetësh i miratuar çdo vit nga Autoriteti Kompetent në vend

Ndarja e përhershme e produkteve organike dhe jo-organike

Njoftimi i trupës së certifikimit **të paktën 48 H** përpara vjeljes

Informacion mbi **sasitë e sakta të vjela**

Kërkim shkencor në bujqësi/ arsim formal ose

Prodhimi i farës, material për shtim vegjetativ dhe fidanë

- **Ndarje e përhershme** e produkteve organike dhe jo-organike
- Njoftimi i trupës së certifikimit **të paktën 48 H** përpara vjeljes
- Informacion mbi **sasitë e sakta të vjela**
- **Miratim i përvitshëm** nga Autoriteti Kompetent në vend

Livadhe të përdorura ekskluzivisht për kullotje (por jo për prodhim sane)

- Në këtë rast varietetet organike dhe jo-organike mund të jenë identike, njësitë duhet të jetë të ndarta qartazi.

OMGJ



- **Përdorimi i Organizmave Modifikuara Gjenetikisht dhe produkteve nga OMGJ si**
 - Produkte të mbrojtjes së bimëve
 - Plehëra dhe përmirësues të tokës
 - Fara
 - Material për shtim vegjetativ
 - Mikro-organizma

është i ndaluar në bujqësinë organike



Faleminderit!